Kronikë

Report Tv siguron foton ekskluzive të Nuredin Dumanit në momentin e arrestimit! Shkoi të vriste Talo Çelën në Elbasan, por mbeti vetë i plagosur

Pasi u qëllua mbi 20 herë në drejtim të makinës ku ndodhej, Nuredin Dumani shkoi të fshihej në një apartament në Fier, megjithatë vendndodhja e tij u zbulua nga policia, që i vuri prangat. Policia ka publikuar video nga momenti i arrestimit të të shumëkërkuarit, i cili shihet i gjysmë i zhveshur, ndërsa në shpinë i dallohet fashimi i bëri pasi gjatë atentatit mbeti edhe ai vetë i plagosur.

■ Pas përplasjes me armë Dumani u fsheh në një pallat në Fier, flasin fqinjët: Banesën e mori me qira para një jave, u tmerruam kur erdhi policia
■ Del video, me pranga në duar, momenti kur futet në furgonin e policisë bashkëjetuesja e Nuredin Dumanit
■ Plumbi pas shpine i ka prekur mushkëritë, Nuredin Dumani i nënshtrohet operacionit te Trauma, ndodhet në gjendje të stabilizuar
■ 'Luftë' me armë mes të 'fortëve' në Elbasan! Nuredin Dumani shkoi t'i bënte atentat Talo Çelës, 'ushtarët' e tij e plagosin, e qëllojnë mbi 20 herë brenda BMW-së

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Arsen Rusta
30 Mars, 07:30 | Përditesimi i fundit: 30 Mars, 16:20

Report Tv ka siguruar foton ekskluzive të Nuredin Dumanit në momentin e arrestimit. Ai u vu në pranga mbrëmjen e djeshme, vetëm dy orë pas përplasjes që mendohet se ka ndodhur ***mes tij dhe Talo Çelës***, ndërsa u kap në një apartament, bazë e tij e fshehtë në Fier. Më herët policia ka publikoi edhe video, ku Dumani shihet gjysmë i zhveshur, me pranga në duar dhe i fashuar në shpinë, ku mori një plumb gjatë shkëmbimit të zjarrit me ushtarët e Talo Çelës. Nuredin Dumani është dërguar në Spitalin e Traumës, si pasojë e plagës, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se së bashku me të në aksionin e policisë, u arrestuan edhe 3 të tjerë, ku njëri prej tyre ishte 'ushtar' i Dumanit, Henrik Hoxhajt, 40 vjeç, i cili u kap i armatosur me një armë zjarri pistoletë në brez dhe një pistoletë në automjet, ndërsa nuk dihet ende identiteti i 2 të tjerëve dhe as roli i tyre në ngjarje. Në bazën ku ai ishte strehuar Dumani u gjetën jelek antiplumb, dylbi dhe snajper dhe armë tjetër.

Ngjarja ndodhi në aksin rrugor Elbasan-Peqin pasditen e djeshme, në të njëjtin vend ku kanë ndodhur dhe atentate të tjera. Fillimisht u njoftua nga policia për BMW-në që u qëllua me breshëri dhe që ishte më targa të vjedhura në qytetin e Durrësit që në prill të vitit 2021. Mjeti BMW ishte i Nuredin Dumanit dhe pas shkëmbimit me armë zjarri që mendohet se ka pasur me Talo Çelën, braktisi makinën dhe u largua nga vendi i ngjarjes menjëherë pas të shtënave. Gjatë kontrollit policia gjeti në automjet një kallashnikov edhe një bidon me 5 litra benzinë.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Report Tv siguron foton ekskluzive të Nuredin Dumanit në momentin e arrestimit në Fier

Nuredim Dumani pas plagosjes është fshehur në një pallat 8-katësh në lagjen Apollonia në Fier. Ai fshihej në një banesë në katin e 4, ku bashkëjetonte me një vajzë nga Kosova. Sipas banorëve ajo banesë ishte marrë me qira një javë më parë. Pas arrestimit të dumanit, policia ka shoqëruar në polic edhe bashkëjetuesen e tij, e cila është marrë në pyetje. Nuredin Dumani është plagosur me plumb pas shpine që i ka preku edhe mushkëritë gjatë shkëmbimit të zjarrit në Papër të Elbasanit me Talo Çelën.

Në vendin e atentatit shkoi edhe drejtuesi i Policisë së Elbasanit, Ardian Çipa, kurse shërbimet e Policisë po krehin zonën me qëllim kapjen e personave të përshirë.

Historia e Nuredin Dumanit dhe Talo Çelës, që nga miq u shndërruan në armiq
Historia nis me vrasjen e vëllezërve Besmir dhe Viktor Haxhia në Durrës më ***27 prill 2020*** dhe si edhe Dorian Shkoza dhe Anxhelo Avdia në ***2 mars 2020***, ku Nuredin Dumani akuzohet së bashku me Talo Çelën. Megjithatë, hetuesit kanë dyshime se mes Dumanit dhe Çelës ka patur mosmarrëveshje që pas eleminimit në Sinaballaj të Rrogozhinës të ***Klevis Kapllanajt***.

3 ditë pas vrasjes së 33-vjeçarit, në automjetin e tij mëngjesin e 17 shtatorit u vra dhe ***Bujar Çela***. Kapllanaj dhe Dumani, sipas prokurorisë, kanë qenë miq. Pra dyshohet që Talo Çela ka ekzekutuar Klevis Kapllanajn, shokun e Nuredin Dumanit, prandaj ky i fundit në shenjë hakmarrjeje i ka vrarë të vëllanë, Bujar Çelën.

Nuredin Dumani ne momentin e arrestimit

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:14

Report Tv siguron foton ekskluzive të Nuredin Dumanit në momentin e arrestimit në Fier

Report Tv ka siguruar foton ekskluzive të Nuredin Dumanit në momentin e arrestimit nga policia në Fier. Dumani u arrestua mbrëmjen e djeshme, 2 orë pas atentatit ndaj Talo Çelës, ndërsa u gjet në një apartament, bazë e tij e fshehtë në Fier.

Ora 11:16

Plagosja e Dumanit në Papër të Elbasanit, u qëllua nga dy armë, e paqartë nëse kishte shkëmbim zjarri apo u qëllua nga i njëjti drejtim

Makina me të cilën udhëtonte Dumani

Detaje të reja kanë dalë në lidhe me plagosjen e Nuredin Dumanit në Papër të Elbasanit gjatë kohës që ka qenë në BMË me xhamat e zinj. Report Tv ka mësuar se në Papër grupi hetimor ka gjetur më shumë se 20 gëzhoja kallashnikovi.

Këta plumba kallashnikovi janë të dy armëve të ndryshme. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse kemi të bëjmë me shkëmbim zjarri apo armë që janë qëlluar nga një drejtim.

Provat e mbledhura në vendin e ngjarjes janë dërguar në laboratorin e Policisë Shkencore për të përcaktuar më tej dinamikën.

Ora 11:10

Del video, me pranga në duar, momenti kur futet në furgonin e policisë bashkëjetuesja e

Nuredin Dumanit

Report Tv ka siguruar videon e momentit të shoqërimit të bashkëjetueses së Nuredin Dumanit. Ajo shihet me pranga në duar, ndërsa futet në furgonin e policisë, ndërsa u shoqërua në komisarit ku dha dëshminë e saj. Nuredin Dumani dhe gruaja nga Kosova, jetonin sëbashku në apartamentin ën Fier, ku u kap i shumëkërkuari.

Ora 10:19

Plumbi pas shpine i ka prekur mushkëritë, Nuredin Dumani i nënshtrohet operacionit te Trauma, ndodhet në gjendje të stabilizuar

Nuredin Dumani është plagosur me plumb pas shpine që i ka preku edhe mushkëritë gjatë shkëmbimit të zjarrit në Papër të Elbasanit që dyshohet se u qëllua nga ushtarët e Talo Çelës. Pas arrestimit në një banesë ku fshihej në Fier ai u dërgua te Trauma në Tiranë , ku i është nënshtruar një operacioni kirurgjikal.

Sipas burimeve për Report Tv nga Trauma, Dumani ka plagë me armë zjarri në mushkëri, ndërsa është në mjekim intensiv, pak më i stabilizuar se dje.

Edhe pse i është nënshtruar ndërhyrjes së parë, plumbi nuk i është hequr, pasi ka komplikacione të shumta në mushkëri. I është vendosur një aparaturë për pastrimin e mushkërisë dhe më pas do të futet në operacion për heqjen e plumbit.

Nëse gjendja do të përmirësohet, pritet të merret në pyetje në ambientet e spitalit nga hetuesit.

Ora 09:51

Pas përplasjes me armë Dumani u fsheh në një pallat në Fier, flasin fqinjët: Banesën e mori me qira para një jave, u tmerruam kur erdhi policia

Një ditë pas arrestimit të Nuredin Dumanit dera e apartamenti të tij ku fshihej ruhet ende me dy policë dhe është i rrethuar me shiritat e zonës së krimit. Arrestimi i Dumanit në mes të natës nga forca të shumta të policisë, ka tmerruar banorët e pallatit, të cilët shprehen se ishin në gjumë në momentin kur dëgjuan ulërima "hapni derën, policia".
Ata thonë se nuk e dinin se kush ishte dhe se banesa ishte marrë me qira para një jave.

> *"Unë tani e mora vesh, nuk dimë gjë fare. I gjithë pallati ishte në terror. Pallati është i banuar me qiraxhinj dhe familjarë. Hapni derën jemi polici bërtisnin, gjuanin derën me shkelma*
>
> *"Ne e dinim që atje banonte në italian dhe ka qenë shumë i rregullt ai. Italiani iku para një jave", thanë fqinjët.*

Nuredim Dumani pasi shkëmbimit të zjarri ku mbeti i plagosur në mjetin e tij tip BMW në Papër të Elbasanit, iku për t'u fshehur në një pallat 8-katësh në Lagjen Apollonia në Fier.

Ai fshihej në një banesë në katin e 4, ndërsa u arrestua nga policia.

J.SH./Sh.Sh/Shqiptarja.com

TAG: Elbasan | Fier | atentat | nuredin dumani | talo cela

Komento

Komente

Taulant: 30/03/2022 16:36

Gangsteri qe jeton si qen ne nje apartament te lodhur me qira.

Përgjigju

Berti: 30/03/2022 16:03

Ky e gjen Talon per atentat! Shteti me gjithe strukturat e veta nuk e gjen dot!! Punesojeni kte tipin se e beka punen me mire se 10.000 Police bashke.

Përgjigju

Tosi: 30/03/2022 08:58

Ka nje parim baze te shtetit ligjor qe quhet prezumimi i pafajsise dhe nje tjeter qe nuk ka denim pa vendim te nje gjykate te bazuar ne ligj! Nje individ qe akuzohet apo eshte ne kerkim per krime, kushdo qofte ai, edhe me maskarai, duhet te trajtohet sipas ligjit qe ndalon kategorikisht cdo lloj veprimi apo sjellje te shtetit ne forme denigruese! Sot, Drejtori i Policise shkelmoi edhe ate maske formale qe policia jone abuzuese kishte. Pa pike pergjegjshmerie, profesionalizmi apo morali. Cjane keta more kaq injorante? A jane vete apo i deh karrigia? E pabesueshme! Ti hapesh vendit edhe nje telash me shume ne rekordet e panumerta te organizmave te te drejtave te njeriut, UN, AI, apo CAT! Foto si te Abu Graib! Po pse? Per qef!!!!

Përgjigju

Kosi: 30/03/2022 11:30

Po ik mer rrot ka.i

Tope: 30/03/2022 08:41

Lereni te ngordhe qenin

Përgjigju

Shkodra: 30/03/2022 08:40

Po policia ku ishte kur keto benin xhiro me makina me xhama te zi e me arme dy personat me te rrezikshem ne shqiperi?? Kush e mbron ket talon qe nuk e arrestoni gjith keto vite ?? Aq esht elbasani

Përgjigju

Vlora: 30/03/2022 17:14

Uo figure ai 500 mij lekshi vjeter qe nerr polici nuk te ben trim per te kap langot e pushtetareve politik. Taua do jete ne ndonje vil politikani duke bere orgji tani..

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Arrestimet e SPAK, a po bëhet drejtësi për çështjen e inceneratorëve?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë



VIDEO nga momenti i arrestimit të Nuredin Dumanit në Fier
29 Mars, 23:05

Kronikë



'Luftë' me armë mes të 'fortëve' në Elbasan! Nuredin Dumani shkoi t'i bënte atentat Talo Çelës, 'ushtarët' e tij e plagosin, e qëllojnë mbi 20 herë brenda BMW-së (VIDEO)
29 Mars, 18:04

Kronikë

Aksident në Lushnjë, 'Benz'-i përplas motorin, humb jetën 50-vjeçari
29 Mars, 17:09

Sociale



Fier/ Bankers Petroleum rehabiliton rrugën Kallm i Madh-Kallm i Vogël në Fier, investim 37 mln lekë
29 Mars, 16:00

Kronikë

Përdhunoi 17-vjeçaren, arrestohet i riu në Elbasan
29 Mars, 12:33

Politikë



Arrestimet për inceneratorin e Fierit, Basha: Rezultat i punës së PD, por nuk mjafton, duhet të dënohen përgjegjësit kryesorë të kësaj afere ministrat dhe Rama
29 Mars, 11:17

Kronikë

Kronikë



Sociale

Inceneratorët në Elbasan e Fier, tjetër akuzë për Kokën e Zoton! Në Kuvend kërkesa e SPAK për arrestimin e Alqi Bllakos! 6 të tjerë në burg e 4 'arrest shtëpie'! Sekuestrohen 3.3 mln € pasuri

Arsen Rusta

29 Mars, 08:32

Përndiqte në mënyrë të përsëritur 16-vjeçaren, shpallet në kërkim i riu në Fier

27 Mars, 11:02

Nga serat e Fierit në tregjet e Tiranës çmimi i luleshtrydhes gati trefishohet! Prodhuesit e shesin 110 lekë/kg, qytetarët e kryeqytetit e blejnë me 300 lekë/kg

26 Mars, 16:47

Kronikë

U dënua për shpërdorim detyre, lirohet nga burgu ish-drejtori i Policisë së Vlorës

25 Mars, 19:29

Sociale

Konfirmohen dy vatra të reja të virusit të shpendëve! Në Divjakë pulat e ngordhura nga gripi u groposën në kanal nga banorët duke rrezikuar përhapjen e infeksionit

25 Mars, 14:28

Shëndeti

Konfirmohet gripi i shpendëve edhe në Divjakë! Pulat e ngordhura u groposën në kanal nga banorët duke rrezikuar përhapjen e infeksionit

25 Mars, 12:51

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje